



Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosova

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Në pajtim me nenin 24 paragrafi 2.2 si dhe në pajtim me nenin 59 paragrafi 1 dhe nenit 62 të ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale cakton shumën e shpenzimeve minimale me qëllim të rregullimit të shpenzimeve financiare të nevojshme për kryerjen e hulumtimeve një vjeçare më të cilat planifikohet që me sukses të realizohet plan programi i hulumtimeve, në mbledhjen e mbajtur me 13.07.2011, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

(KPMN NR. 003/2011)

MBI SHPENZIMET MINIMALE TË HULUMTIMIT

Neni 1

Qëllimi

- 1.1. Me anë të këtij udhëzimi rregullohet dhe përcaktohet shuma e mjeteve financiare të shpenzimeve minimale të nevojshme për kryerjen e hulumtimeve gjeologjike në zonën e licencës. Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e licencës së hulumtimit, dinamiken e punëve hulumtuese, dhe punën shumë të ndjeshme në sektorin minerar me anë të këtij udhëzimi synohet të arrihet caktimi i një shume të mjeteve minimale e cila do të ishte në përputhshmëri me përvojat e vendeve të tjera dhe që nuk do të ndikonte negativisht në nxitjen e investimeve hulumtuese.
- 1.2. Shpenzime minimale është vlera në para, e nevojshme për të kryer me sukses dhe cilësi një plan program të hulumtimit në kuadër të punës së licencës së hulumtimit brenda atij viti.
- 1.3. Shpenzimet e administratës, duke përfshirë taksat e licencave, nuk duhet të përfshihen në vlerësimin e shpenzimeve minimale.
- 1.4. Në rast se shpenzimet sipas paragrafit 1.3 janë të përfshira si shpenzime të plan programit këto nuk duhet të kalojnë 10% e shpenzimeve për hulumtim.
- 1.5. Shpenzimet e raportuara duhet të specifikohen dhe të argumentohen. Vetëm shpenzimet aktuale të kryera në punën e hulumtimit dhe të argumentuara mund të përfshihen në vlerësim të kryerjes apo mos kryerjes së shpenzimeve minimale.

Rr. Armend Daci Nr. 1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 240 252
Fax: +381 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

- 1.6. Në qoftë se shpenzimet janë më të pakta se shpenzimet minimale të përcaktuara sipas këtij udhëzimi, atëherë i licencuari duhet të paguajë diferencën në KPMM si një tarifë të hulumtimit.
- 1.7. Në qoftë se kompania huluntuese ndërpret hulumtimin para skadimit të licencës së hulumtimit, për të cilën gjë bën kërkesë për mbyllje të licencës, shpenzimet minimale vlerësohen si të pranueshme nga data e parashtrimit të kërkesës për mbyllje në KPMM.

Neni 2

Shuma e shpenzimeve minimale

2.1. Vlera e shpenzimeve për të gjitha llojet e hulumtimeve të jetë për sipërfaqe 1ha (një hektar) si më poshtë:

- (a) Viti i par i hulumtimit 10 € (Euro) për 1ha (një hektar)
- (b) Viti i dytë i hulumtimit 20 € (Euro) për 1ha (një hektar)
- (c) Viti i tretë i hulumtimit 30 € (Euro) për 1ha (një hektar)

2.2. Për të gjitha vazhdimet tjera të licencës së hulumtimit të aplikohet vlera minimale e shpenzimeve.

- (a). Për çdo vit të licencës 50 € (Euro) për 1ha (një hektar)

Neni 3

Hyrja në fuqi

Me këtë Udhëzim Administrativ shfuqizohet vlera e shpenzimeve minimale të aplikuara deri me tani.

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.



Ahmet Imava
Kryesues i Bordit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale